



Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

Në mbështetje të nenit 3 të Rregullores për organizimin e zgjedhjeve, procedurën e kandidimit, mënyrën e zgjedhjes dhe revokimin e anëtarëve të organeve të Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e mbajtur me **29.11.2024**, miratoi:

RREGULLAT E SJELLJES SË KANDIDATËVE DHE VOTUESVE NË DITËN E ZGJEDHJEVE

Gjatë ditës së votimit kandidatët për anëtarë të Kuvendit të OFTK-ut dhe votuesit nuk lejohen të:

- pengojnë ose tentojnë të pengojnë KNJZ-të dhe KQZ-në në përmbushjen e detyrat të tyre profesionale;
- jenë prezentë në qendrën votuese, përjashtimisht kur ushtron të drejtën e votës;
- premtojnë ndonjë shpërblimi financiar me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve;
- kërcënojnë ose tentojnë për të kërcënuar kandidatët tjerë apo mbështetësit e tyre;
- nxisin cilin do person për të votuar në zgjedhje, i cili nuk ka të drejtë vote;
- votojnë më shumë se një here;
- nxisin personin për të votuar më shumë se një herë ose të votojë në emër të një personi tjetër;
- përdorin gjuhë, në formë të shkruar ose verbale, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë, ose
- Ndërmarrin veprime tjera të cilat nuk janë paraparë në këtë vendim, por të cilat mund të kenë ndikim në rezultatin e proceset zgjedhore.

Vërejtje: Në rast të shkeljes së këtyre rregullave, shkelje këto të cilat duhet të dëshmohen nga personat përgjegjës të vendvotimit, KQZ ndërmerre masa ndaj shkelësve të cilat mund të konsistojnë edhe në diskualifikimin e kandidatit nga zgjedhjet.

Kryetari i KQZ-së

Milazim Gjocaj

